



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....159..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/ 11 / 2023

**VENDIM**

Nr. 43, datë 21 /11/2023

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTËZIMIT, OPERIMIT, MIRËMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISË SË DIGËS DHE LIQENIT ARTIFICIAL TË TIRANËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.11.2023 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, të diges së Liqenit Artificial të Tiranës që administrohet nga Ndërmarrja UKT dhe shfrytëzohet nga Bashkia Tiranë.

Rregullorja e paraqitur është hartuar në vitin 1999 nga ekspertët e Institutit të Studimeve dhe projekteve hidroteknike në kushtet e funksionimit të rregullt të të gjithë elementeve të digës dhe kontrollit dhe monitorimit të digës sipas kërkesave të projektit. Aktualisht, shfrytëzuesi i digës ka evidentuar mos funksionimin e sistemit të Shkarkimit dhe bllokimin e portave të këtij sistemi, mungesën e matjeve të monitorimit për sjelljen e digës, matjeve të filtrimeve në digë dhe matjet e niveleve të ujit tek puset piezometrike, etj. Gjithashtu, kjo rregullore është hartuar përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 8681 datë 02.11.2000 dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004

Aktualisht, diga është evidentuar me probleme teknike të shumta, sistemi i shkarkimit të ujrave të tepërta është i dëmtuar dhe portat e punës dhe të remontit të këtij sistemi janë jashtë pune që prej me se 20 vitesh, sistemi i alarmit dhe kontrolli i digës sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi mungon. Në zonën poshtë digës, është rritur ndjeshëm rrishtu për humbje jete të njerëzve për shkak të ndërtimeve dhe zhvillimit urban në të gjithë zonën që mund të përmytet nga prurjet maksimale apo prishja e mundshme e digës si dhe masave paralajmëruese në rastet e emergjencave civile për shkak të prurjeve të mëdha apo prishjes së mundshme të digës. Në këtë zone urbane ndodhen me se 40 000 banorë që mund të rrezikohen në rast përmytjesh që mund të ndodhin gjatë operimit dhe shfrytëzimit të kësaj dige.

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM ti kërkojë pronarit dhe administratorit të digës ( UKT dhe Bashkisë Tiranë) të përgatit një rregullore për shfrytëzimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës e cila duhet të marrë në konsideratë problematikat e përmenduar me sipër dhe plotësimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe udhëzimit përkatës të KKDM të përmendur me sipër. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Ti kërkojë UKT dhe Bashkisë Tiranë:

- Përgatitjen e **Rregullores së Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes, Operimit dhe Sigurisë për Digën dhe Liqenin Artificial të Tiranës** në përputhje me kërkesat e nenit 29 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 dhe vendimit të KKDM Nr. 03, datë 19.10.2020; Rregullorja duhet të marrë në konsideratë të gjitha problematikat dhe situatën aktuale të përshkruar në këtë Vendim, duke përfshirë të dhënat teknike për digën, qëllimin aktual të përdorimit të digës dhe rezervuarit, rregulloren e monitorimit të digës sipas kërkesave të nenit 31 dhe 32 të VKM së mësipërme, Rregulloren për provat që duhet të kryhen në sistemet e shkarkimit përpara periudhës së rresjeve, rregulloren e shfrytëzimit gjatë periudhës ujë shumë dhe uëpakët në funksion të qëllimit të përdorimit të saj, të dhënat për grupin e sigurisë së digës si dhe Planin e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për këtë digë si digë me rrisht shumë të lartë në zonat urbane poshtë tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Dorëzimin e kësaj rregulloreje për miratim pranë KKDM sipas kërkesave të nenit 29 të VKM së mësipërme.
- Marrjen e masave për Instalimin e sistemeve ëe monitorimit në digë dhe Sistemit të alarmit në digë dhe në zonën urbane poshtë saj.
- Hartimin e projektit për rehabilitimin e digës, sistemit të shkarkimit të saj, sistemeve të monitorimit të nevojshëm në digë, sistemin e alarmit i cili duhet të marrë në konsideratë jo vetem digën por edhe efektet në rast përmytjesh apo prishje të mundshme të digës për të gjithë zonën ku mund të shkoj vala e përmytjeve. Ky projekt duhet të dorëzohet për miratim në KKDM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI